

BIBLIOTEKA

844-1

L 20

FERIT LAMAJ

BILBILI DHE GJINKALLA

- FABULA
- VJERSHA
- HUMORISTIKE
- EPIGRAME



8/11/8

120

Redaktor
SEVIM ARBANA
Piktur
BARDHYL FICO
Kopertira
JUSUF SHAHINI

Ferit
Lamaj

Ky vëllim ka fituar çmimin e parë në Konkursin Kombëtar të 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

BILBILI DHE GJINKALLA



- FABULA
- VJERSHA
- HUMORISTIKE
- EPIGRAME

FABULA

Redaktor
Ymer Çiraku
Gjergj Kollçi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

NJË THËNIE E RE

Që prej shekujsh rron e thëna:
«Qengj' i urtë pi dy nëna».
Por nuk dini më të renë:
«Pi servili gjithë kopenë!»...!



SEKRETI...


Dëgjonin arinë
në pyll, në kuvend,
kafshë, shpendë ngrinë,
rrinin si mbi gjemb.

— Mjaltin sot te zgjoi
kush e hëngri, kush?
Sorkadhja, palloi
a ti, lepurush?

Ç'më rrini të ngratë?
Ç'më rrini të gjorë?
Po kur e përlatë
s'ju erdhi pak zor!?

Sekreti që heshtnin
na qenka gjetiu:
... Me miza tek veshi
është mbushur ariu...





SYRI, VESHI, HUNDA

Dhe kur sytë syze vunë,
u nxeq veshi: — Hë, moj hundë,
t'u mbush mendja që s'flas kot!
Me hilë u nda kjo botë:
I mbajmë syzet unë e ti;
për të ,parë... sheh ai!...



KUNADHJA DHE THËLLËZA

*Një thëllëzë vetmitare
has kunadhen buzë një are
e në çast u drodh nga frika.*

*— Uh, të tremba, më rëntë pika!
Sa të të prek pakëz në faqe,
të të puth, moj budallaqe!*

*Dhe thëllëza, pak nga pak,
mori zemër, mori gjak:
— Sa e bukur, sa e mirë! —*

*I zgjat faqen gjithë dëshirë.
Grabitqarja nuk vonon,
bën ta puthë, e kafshon...*

DELJA DHE DASHI

Qe një dash, vriste përpjetë:
«Do të bredh ku dua vetë!»
Dhe harbonte larg nga stani.
Më në fund u nxeh çobani.

— More, unë të kam në dorë!
E i vari një këmborë.
Por s'i ulet ajo hundë,
dang e dung këmborën tund.

I thotë delja: — Mor i ngratë,
është këmborë, jo... dekoratë!



KALLI E D'HELPRË

Një ditë lajmi takon d'helprën
— Krahët e gojës d'nakëro!
Më d'cedhtra e shijën jetën,
për këtë flet lachtesia...

— Do bëhë mirë të kyçësh gojën
kësaj qenieje këmbë e gjatë,
kësaj qenieje mushtrorë Trazë,
kësaj qenieje s'ishë d'helprë!

QE Ç'NA QE...

— Qe ç'na qe,
një rrip ullastriku —
— i tha krahut:
— Or lum miku,
s'ke ç'i bën,
u nda ky fat:
ti i shkurtër,
unë ... i gjatë.
Që të flasim
porsi miq,
ja, provo
e më tërhiq!

E tërhoqi
rripin ky;
shkoi një metër,
shkoi dy...
I flet rripi:
— Hë të thashë!
— Prit, — tha krahu; —
prit, avash!
Dhe në çast
e la të lirë...
Mbeti rripi
si i ngrirë.
S'foli më,
se s'kish guxim.
Tani matej
... me centim...